

Për [REDACTED] ata [REDACTED] që nuk [REDACTED] dimë [REDACTED] [REDACTED] ku prehen

Shenjimi i vendvarrimeve të mundshme të të pagjeturve nuk tregon vetëm Shqipërinë tjetër që fshihet në nëntokën e saj, por na tregon edhe se disa prej nesh qenë të aftë ta kthejnë vendin në një hapësirë burgjesh, kampesh, varresh e frike që zgjat deri sot. Fatet e të pagjeturve dhe familjarët që enden në kërkim, si Sizifi me gurin mbi shpinë, duke ia nisur gjithnjë nga e para, dëshmojnë veçse vazhdimin e krimit. Nëse vrasja është një krim, fshehja e trupit dhe moskallëzimi janë krim ende në vijim.

Ndaj kjo ekspozitë është një përpjekje për të ndërgjegjësuar për nevojën për përgjigje të familjeve mbi fatin dhe vendndodhjen e personave të humbur. Është një sprovë e vogël në kërkimin e paqes sociale, që nuk mund të vijë pa i dhënë fund vuajtjeve të atyre që kërkojnë familjarët. Është një përpjekje për të treguar të gjitha kategoritë e të zhdukurve, nga të miturit, te mjekët, inxhinierët, gazetarët, mësuesit, bankierët, familje të tëra, intelektualët e klerikët, nga jugu në veri. Është sa homazh për të humburit, po aq një zë për kraht të mbijetuarve. Fytyrat e fshira të rreth 6 mijë njerëzve janë e shkuara jonë që nuk ka shkuar, janë një e shkuar e pakryer.

Secili varr pa emër dhe secili emër pa varr është një mesazh që duhet ta gjejmë dhe ta përcjellim. Për të mos harruar!

Parlamenti Europian ka miratuar një rezolutë të re në shtator 2019 mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët europiane, duke shprehur respekt për secilën viktimë të sistemeve totalitare, shpreh mbështetje për përkujtimin e tyre dhe shqetësim për përdorimin e simboleve të regjimeve dhe glorifikimin e tyre. Duke pasur parasysh që kujtimet e së kaluarës tragjike të Evropës duhet të mbahen gjallë, në mënyrë që të nderohen viktimat, të dënohen autorët dhe të shtrohet rruga për pajtim, bazuar tek e vërteta dhe përkujtimi, rezoluta e PE thotë se kujtimi i viktimave të regjimeve totalitare, sikundër njohja dhe rritja e vetëdijes për trashëgiminë e përbashkët evropiane të krimeve të kryera nga diktaturat komuniste, naziste dhe të tjera, ka rëndësi jetike për unitetin e Evropës.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit 1944-1991, që prej themelimit, në bashkëpunim me partnerët, e ka vënë fokusin e punës së tij në zbardhjen e së kaluarës. Me synimin që t'u kthejë dinjitetin viktimave pa faj, të respektojë të drejtën e familjarëve për të pasur një varr me eshtrat e të humburve, nismat në këtë lami kanë qenë të shumta.

Shenjimi i vendeve të kujtesës, takimet me të mbijetuar në kampe, propozimet për të nderuar shembujt e qëndrësës, mbledhja e dëshmive, kontributi dhe organizimi i grupeve studimore, deklasifikimi i dosjeve, vënia në dispozicion dhe vetë kjo ekspozitë që sjell raste shqiptarësh të zhdukur dhe raste që familjet kanë mundur t'i gjejnë, synon të ndërgjegjësojë dhe, këdo që ka informacion, të bëjë sot atë që nuk mundi ta bënte nën regjimin komunist.



Burimi: IPP & ICAP

-  Vendvarrimet e Raportuara
-  Burgje Kampe (Punë e Detyruar)

Nëna pa fëmijë

Kunatat Mrikë e Gjelë Gjokola u burgosën nga regjimi komunist kur bashkëshortët e tyre dolën malit si kundërshtarë të sistemit. Gjela ishte lehonë me vajzën triditëshe e Mrika lindi rrugës për në burg. Pas katër muajsh hetuesi, dy gratë me dy foshnjat u internuan në kampin e Tepelenës, ku gjetën kushte ekstreme jetese. Tri vjet më vonë, dy vajzat e vogla vdiqën natën nga mungesa e ujit, bukës dhe sëmundja. "I varrosëm cucat, i varrosëm tu u lshue dhë e gur zalli. Ka qenë një vorr italian, në rraz' të atij muri. I morëm leje komandantit, ramë në zall, morëm ca gur të bardh' si voe (vezë), e i vumë akolle (rreth) për mos me e harrue vorrin..."



Kur u liruan, dy kunatat e shkuan jetën pa u martuar më, të veja dhe pa fëmijë. Derisa në vitin 2006, dy nënat pa fëmijë u kthyen në Tepelenë për të marrë eshtrat e vajzave. "Kemi vojt e i kemi qit cucat prej vorrit. Ptluhun krejt ishin ba. Vetëm nga një copë e vogël e djepave prej pishë kishte mbet... Kemi marr' shenjat e i kemi çu te vorret te kisha e Shna Nolit". Nënata nuk mundën t'u rikthenin jetën, por u vunë në vend dinjitetin.

Në vitet e funksionimit, kampi i Tepelenës ka parë histori ende të patreguara, me shpresë se do të rrëfohen një ditë. Kishte edhe nëna që, kur u liruan nga internimi, i morën me vete fshehurazi fëmijët e tyre të vdekur. Drane Jakja ishte një nga nënat që humbi djalin e saj, Zefin dyvjeçar, në orët e frikshme kur brenda natës në kabanone vdiqën 30 fëmijë. E varrosi duke përdorur disa dërrasa që i mbledhi përreth. 3 muaj më pas, kur i erdhi lajmi që do ta lironin, ajo doli në mesnatë bashkë me të bijën, shkoi te varri i të birit, e zhvarrosi duke e gërmuar dheun me gishta. E mbështolli trupin e tij me çarçalë të bardhë dhe u kthye në kabanon. E mbajti 7 javë fshehurazi trupin në kamp. E pastronte me raki që askush të mos e kuptonte që ajo jetonte me djalin e vdekur. Kur gjeti një makinë për t'u kthyer në Tropojë, ndaloi në pazar dhe i bleu të birit veshmbathje të reja. Rruga nga Tepelena deri në Tropojë 7 ditë i shkoi, por atje mundi më në fund të varrose djalin denjësisht.

Kishte edhe nëna që, kur u liruan nga internimi, i morën me vete fshehurazi fëmijët e tyre të vdekur.

Të mbijetuarit përmendin me dhimbje historinë e një malësoreje. Ai i Cuklinës është mes rasteve më të trishtat. Nëna fatkeqe që humbi dy fëmijët brenda ditës, njërin në mëngjes e tjetrin në darkë, mundi të dalë e gjallë nga kampi. Por ngjarja u kthye në tragjedi. Motra e dy të vegjëlvë, arratisur në Mal të Zi, kur mori vesh lajmin, vrau veten. Ndërsa Cuklina, kur u lirua dhe u kthye e vetme në kullën ku dikur jetonte me 3 fëmijë, i dha fund jetës duke e shuar familjen përgjithnjë. Eshtrat e fëmijëve të saj nuk i kërkon më askush. Ajo është shuar me pengun që i la larg.



Një varr për të gjithë

Në datën 19 shkurt të vitit 1951, në orën 18.00 pranë Ambasadës së Bashkimit Sovjetik në Tiranë, shpërtheu një lëndë eksplozive. Ngjarja që njihet si bomba në Ambasadën Sovjetike, u përdor si pretekst për ekzekutimin e kundërshtarëve të regjimit. Një javë më pas, mesnatën mes 25 dhe 26 shkurtit, 22 intelektualë të vendit, nxirren nga qelqet e burgut të lidhur në pranga dhe vihen në një kamion që ka marrë udhën për nga Ndroqi. Banorët e zonës kanë parë gjatë atyre ditëve të hapet një gropë e madhe në Mënik, afër Urës së Beshirit. Rreth orës 12:30- 1:00 të natës dëgjohej breshëri armësh dhe britma. Britmat e një gruaje. (Thuhet të ketë qenë Sabiha Kasimati). Atë natë, banorët nuk e dinin se jetët që fikeshin qenë pushkatime pa gjyq. Njëri prej tyre që u ndërrua me ushtarët orët e para të 26 shkurtit, u porosit të hapte fjalën se qenë ekzekutuar kuaj të lodhur. Të nesërmen, kryetari i këshillit të fshatit kaloi për të parë ç'kishte ndodhur dhe pa të shpërndara këpucë e rroba. Duke qenë se trupat e pajetë nuk ishin mbuluar mirë dhe pranë varrit të pamatë afroheshin qentë, ai njoftoi eprorët se çfarë po ndodhte. U porosit të heshte. Disa ditë më vonë, një ekskavator e rrafshoi vendin. Pavarësisht porosive, banorët e zonës ishin të vetëdijshëm se breshëritë e shpeshta në errësi, britmat dhe lëvizjet e kamionëve netëve pranë urës, nënkuptonin jetë të humbura. Pronarët e truallit e kishin lënë me amanet që ajo tokë aty të mos përdorej kurrë për gjë tjetër, veçse për të mbjellë pemë. Ata e dinin që atje kishte varre të panumërta të pushkatuarish nga diktatura.



Eshtrat e 22 intelektualëve që u ekzekutuan në shkurtin e vitit 1951, u gjetën nga ngulmimi i Hysen Shehut, djali të njërit prej viktimave. Më 1993, ai mundi të mbledhë informacione të dëshmitarëve dhe banorëve të zonës, si familja e ish-kryetarit të këshillit të fshatit, Kadri Hysa. Me identifikimin e vendit, pas 6 muajsh gërmime, në 5-6 gropa, u has në një unazë që shenjoj lidhjen me të pushkatuarit për bombën në Ambasadën Sovjetike. Në qershorin e vitit 1993 u krye zhvarrimi i tyre dhe më pas rivarrimi në varrezat e Dëshmorëve të Kombit. Sot, në nderim të tyre, një rrugë mban emrin "26 shkurti". Me propozim nga AIDSSH, Presidenti ka vlerësuar me titullin "Për Merita të Veçanta Civile" Kadri Hysën, Fazli Hysën, Gëzim Mullajin, Aleksandër Dhimën, Hysen Shehun dhe Osman Kacelin, si dëshmitarë dhe kontribues të zbulimit, gjetjes dhe vënies në vend të drejtësisë për 22 intelektualët e pushkatuar pa gjyq 68 vite më parë.

Prindër në "Sirtar"

Një nga kamionët, në të gdhirë të datës 14 maj të 1949 gremiset në humnerën e fshatit Buz, bashkë me të internuarit



Pas dy vitesh burg (1944-1946) e pak muajsh në shtëpi, Fadil Petrela bashkë me të shoqen Xhuma (Abaz) Kupi dhe katër djemtë e tyre u internua në Berat. Mesnatën e 13 majit 1949, një autokolonë me disa kamionë mbërriti para kampit. Urdhri i transferonte të gjithë në Tepelenë.

Një nga kamionët, në të gdhirë të datës 14 maj të 1949 gremiset në humnerën e fshatit Buz, bashkë me të internuarit. Fadili dhe Xhuma ishin të vetmit që humbën jetën, ndërsa fëmijët u gjetën të gjallë nëpër ferra. "Gratë e tmeruara të asaj makine i mbanin katër fëmijët e vegjël që qanin mbi prindërit e vrarë, ndërsa burrat hapnin varrin si të mundnin. Rojet nuk donin t'i merrnin kufomat me vete. Vegla nuk kërkoi dot nëpër fshatra, kështu që varri u hap aty nën rrugë, tamam me thonj", shkruan sipas rrëfimeve të dëshmitarëve piktori Lekë Tasi. Të internuarit e

pranishëm thonë se ua hapën varret buzë rrugës me kapakë tenxheresh, pak metra nga vendi i aksidentit dhe ikën drejt Tepelenës bashkë me katër djemtë e çiftit Petrela, hallën dhe gjyshen e tyre. Fadili e Xhuma u lanë në shtëpinë ku gjetën vdekjen për më shumë se dy dekada.

23 vjet më vonë, një banor i Buzit mbërriti në Tiranë duke kërkuar nëpër qytet shtëpinë e bijve të çiftit Petrela. Ishte natë kur trokiti mbi derën e tyre. Nuk u prezantua kush ishte, nuk e tregoi hapur as fytyrën nga frika, por në gjysmerrësirën e natës pëshpëriti: "Kam ardhur vetëm për t'ju lajmëruar. Zona po shpyllëzohet për të hapur tokë të re të varri i prindërve tuaj, e jani të mermi eshtrat që të mos i humbni përgjithnjë". Ishte viti 1972. Djali i madh u nis për të shkuar tej Urës së Goricës me një të afërm. Gërmuan ku mendonin se preheshin Fadil e Xhuma Petrela, derisa i gjetën eshtrat. I morën me një thes dhe i sollën shpeshurazi në Tiranë. Djemtë i mbajtën të fshehura eshtrat e "prindërve në sirtar", duke shenjuar në një mënyrë krejt të pazakontë, pas kaq vitesh, takimin e munguar me ta. Disa muaj më vonë mundën të siguronin përmes një të njohuri që punonte në Tufinë, një varr pa emër në një parcelë që nuk binte në sy. Vetëm pas 1990-s, mbi varrin e tyre të dytë u vunë emrat dhe vdekja u regjistrua zyrtarisht. U deshën katër dekada që dy bashkëshortëve t'u vihej dinjiteti në vend. Fëmijët e mbetur jetimë, të rritur mes kampit e Tiranës pa prindër, ia dolën të gjejnë një strehë për prindërit, 40 vite pas ndarjes me ta. Në kuadër të 30 gushtit, Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve, me propozim të AIDSSH, Presidenti i Republikës vlerësoi me tituj nderi "Për merita të veçanta civile" djemtë e familjes Petrela, vëllezërit Bujar, Ylber, Halil e Seit, dhe Shqipjon Topullin (pas vdekjes), të përfshirë në trajtimin njerëzor të viktimeve të para të kampit të Tepelenës, Fadil dhe Xhuma Petrela, histori zhdukjeje dhe solidariteti e shtrirë në kohë, nga viti 1949 deri në 1993, ku triumfon dinjiteti i njerëzve të thjeshtë.



Floriri i Stanislav Nëntokës Zuber



"Dhe tani ja ku ishim të dy: – ai i katandisur një grusht njeri, unë një skelet i gjallë i ngarkuar me hekura. Me Zuberin shkëmbenim ndonjë fjalë: – ai, i shtrirë përdhe, – unë, i varur. E pyesja se ç'murmuriste, thoshte: ---Tani jam duke u lutur. Unë u besoj ideve që jetojnë dhe do të jetojnë për mijëra vite.... Ja tani, kur unë i falem Krishtit, i them: – edhe unë do të duroj dhe do të qëndroj si ti."

- Citim nga Petro Marko

Në Tiranën e fundviteve 1940 ai mbahej mend si inxhinieri i Kafe Splendit, pinjoll i një familje shkencëtarësh nga Polonia, zbuluesi i naftës në Shqipëri. Vetmitari polak që endej mes dhomës së vogël të hotelit të ministrisë, mes miqve shqiptarë e të huaj, i përndjekuri dhe i përgjuari.

"Ai ishte një zotëri, – kujton Janina bashkëkombase e tij, -në moshë, me një trup mesatar, por me një pamje të thjeshtë, i gjallë e me energji, gjë që ishte disi kontraktore me flokët e tij. Në shoqërinë ku takoheshim, gjithmonë e vije re rrethuar nga vizitorë të vëmendshëm".

Pat ardhur në Shqipëri me firmën italiane AGIP më 1927 për të kërkuar naftë e në 20 vitet e qëndrimit zbuloi naftën e Patosit e Kuçovës dhe i la trashëgim Arkivit Qendror të Gjeologjisë dhe të Institutit të Naftës 551 punime dhe bocete shkencore dhe 480 punime të plota. Prof. Stanislav Zuber është hartuesi i Hartës Tektonike, i Hartës Gjeologjike dhe Hartës Minerale të Shqipërisë që përdoret edhe sot nga gjeologët tanë.

Shkencëtar i rangut evropian, kohën e luftës e kaloi në Kuçovë, ku nga bombardimet e aviacionit anglo-amerikan humbi jetën e shoqja. Zuberi mbeti fillikat. Erdh në Tiranë pasluftë e në pritje të riatdhesimit, Zuberi u thirr si këshilltar i gjeologjisë pranë Këshillit të Ministrave dhe mandej si këshilltar pranë Nako Spiros, asokohe ministër i Ekonomisë. Nga kjo detyrë kundërshton fort dërgimin e rezervave shqiptare të naftës në Jugosllavi.

Raporti i parë zyrtar që denoncon profesorin polak për "veprimtarë reaksionare e agjenturore" është i datës 24 tetor 1945.

Ndërsa mban kontakt me miqtë shqiptarë dhe përpigjet të gjejë burime uji, nga përndjekja, mësohet se takohet me intelektualë, nga "dyqani i Ali Kacellit ku shkruan letra, te Teodor Luarasi, te Filip Theodhosi- drejtori i hotel "Dajtit", te Alfred Ashiku me të cilin ha drekë e darkë, nga kafe "Berati", te takimet e herëpashershme me Besim Kokalarin, Sabiha Kasimatit e Eqrem Çabejn. Takon elementë të pakënaqur, rri me italianë, takon edhe inxhinier Gjovalin Gjadrin, paguan gjithnjë vetë dhe kur flet, e dëgjojnë të gjithë". Në dosje i shënohet që nuk ka ndihmuar partizanët gjatë luftës, ka pasur miqësi me gjermanët, sidomos e shoqja Mitilde, dhe ka sabotuar punën. Nënvizohet të ketë thënë se ai priste që qeveria e kohës të binte me ndërhyrjen e anglo-amerikanëve.

Arrestohet më 15 qershor 1947. Me akuzën e agjentit dhe sabotatorit të ekonomisë socialiste, Stanislav Zuber, njohës i 12 gjuhëve, rrëfehej gjatë qershorit 1947 në zyrat e Sigurimit të Shtetit në Tiranë. I merren të gjitha shënime, librat, fletoret dhe letërkëmbimet. Në birucë e pyesnin pse nuk ka shënuar flori në hartë. U thoshte se nëntoka nuk kishte.

Genc Luarasi, djali i mikut të tij, Teodorit, kujton që me gjyshen shkonin tek ambasadori polak në Shqipëri, zoti Micel, në Hotel "Dajti", ku i kërkonin ndërhyrje për lirin e profesor Zuberit. "Shkuan disa herë në burg t'i çonin ushqime dhe veshmbathje. Nuk e dinin nëse i jepeshin apo jo, derisa një ditë u thanë se nuk ishte më e nevojshme".

Deri në vitin 1991, askush nuk e dinte fatin tragjik të vdekjes së tij nën tortura, në qelitë e Sigurimit. Ai emërtoi sipas zonave pasuritë e nëntokës së Shqipërisë, pa e ditur se do të tretej në një nëntokë pa emër. Burri që vuri themelet e kërkimit të naftës është ende një njeri i humbur.

Ka vetëm një dëshmi që i tregon çastet e tij të mbrame, diku në rrugën "Mine Peza": është shoku i tij i qelisë, Petro Marko, që në librin "Retë dhe gurët", ka publikuar një dëshmi të fortë nga kujtesa e qelisë së burgut të Tiranës, në orët e vona të 18 tetorit 1947, pasi e kishin rrahur pse nuk gjente flori.

U hap dera. Hyri një polic trupmadh dhe i bërtiti Zuberit. – Ç'punë bën ti? – Gjeolog që zbulon pasuritë e nëntokës, – tha Zuberi. Roja i këputi një shkëlqim prapa veshit duke i thënë, – Tani shko e zbulo pasuritë e nëntokës. Pashë Zuberin të shtrirë, me duar e me këmbë të hapura dhe me një curmë gjaku që i buronte nga goja. Vranë kulturën, vranë shkencën, vranë jetën. E kapën nga këmbët, e hoqën zvarrë, e nxorën jashtë dhe mbyllën derën, duke më lënë mua në birucë fantazmën gjakatare të kohës që vuloste turpin e këtij shekulli"

-Citim nga Petro Marko

Më 17 tetor 1991, në qytetin e Kuçovës u përrua busti i profesorit të madh. Më 1992 u nderua me medaljen "Martiri i Demokracisë".

Më 17 tetor 2011, Inxh. Stanislav Zuberit iu akordua Urdhri "Nënë Tereza" (pas vdekjes).

Fëmijët e Parritur

Nëse do të keshim të imagjinonim vizualisht dhe mandej të kuptonim odishën e kërkimit me dëshpërim, për 11 dhënë një fëmijë të vdekur një varrim të deriç, duhet të ulemi para një ekrani - vetëm - dhe të shohim filmin hungarez "I biri i Saulit" të László Nemes.

Ndonëse nuk ka dokumente zyrtare, sipas përflogaritës së ish-të dënuarve politikë, në Kampin e Tepelenës mendohet se kanë vdekur rreth 300 fëmijë të internuar.

"Vetëm në një natë kanë vdekur 33 foshja. Një prej tyre shpëtoi. Nisën ta thërrisnin "Beba", dhe sot ka akoma ende këtë emër", - thotë Lek Pervizi, një piktor 90-vjeçar, që kujton qdo gjë që ka përjetuar në Tepelenë. Beba është bashkëshortja e tij dhe janë mitur bashkë nëpër kampe. Si dëshmitar, ai ka vizatuar që në vitet 1950 skica se si ishte kampi, 600 veta në një kazermë, 4500 në gjithë kampin. Skicat e tij mbeten ende sot pamjet e vetme që dëshmojnë si funksiononin 5 kabanonet si kamp. Njëherësh, përmes skicave të tij, ai ka shenjuar edhe dukuritë e ngjarjet e rënda që kanë ndodhur në Tepelenë, si vdekja e fëmijëve.

"Kishte ngrica. Nénat na lanin jashtë. Në mbremje, binim për të fjetur, por në mëngjes jo të gjithë fëmijët zgjoheshin. Kishte ngricë në gjumë" kujton Simon Mirakaj, një jetëtar i shpëtuar nga Tepelena.

Ish-të internuarit e kanë cilësuar kamp shfarosje jo, për shkak të numrit të madh të të miturve që humbën jetën prej mungesës së ushqimit, keqshqyerjes, higjienës, ujit që konsumonin dhe mungesës së kujdesit shëndetësor.

Kampi që kishte funksionuar gjatë luftës si kazermë ushtarake e italianëve, nuk ishte çmnuar para vendosjes së të internuarve politikë. Disa fëmijë e humbën jetën duke luajtur me mina në oborrin mes kabanonëve, jashtë vëmendjes së të rriturve. Hamit Balaj nga Troçoja mëfën se aty, një prej fëmijëve të ndarë nga jeta, ka qenë dajja i tij - "Prindërit e nënës ishin arratisur duke menduar të përgatisnin kushtet dhe të ktheheshin për të marrë tre fëmijët. Por një ditë pas arratisjes, fëmijët i internuan në Tepelenë. Nëna ime, Mine Mulosmanaj, 13 vjeçe, kishte ardhur në kamp, me të motrën 11 vjeçe dhe vëllanë e vogël 9 vjeç. Një ditë kanë qenë të gjithë jashtë. Nëna dëgjoi zhurmë mine. Trupi i një fëmije shpërtheu në ajër. Prej tij mbeti vetëm një çorapë. Çorapja ishte e të vëllait, Shemsedin Çelë Mulosmanaj. Ai po luante me mina dhe njëra i kishte shpëthyer në duar."

"Vllau ishte amaneti im. Isha ba nanë për të. Qysh se shkum në kamp, isha mundu me e ngop se paku me bukë. Atë ditë i dhashë me hanger, të paktën. Më duket



se u ngop, se ma dha mue një copë bukë. Kjo më qetëson disi. Nuk iku i unhtë. Pashë një shpërthim e dëgjova një zhurmë. Kur u afrova, kishte mbet vetëm një çorapë i tij. Nuk e deshta ma veten. Kam qe e bërtiti, kam vu kujën. Si e humba vëllanë para syve... Mora një çarçaf e mblocha copat e trupit të tij. Aq sa munda... Nuk kisha si me i ba arkivoll vëllait tem të vogël. Mblocha pak drasa e i ngula në tokë, që me mujt me vu trupin e tij në të. E mbuloava me dhe, si mufta e si dita. Prej asaj dite kam rujt vetëm çorapën e tij. As vetë nuk e di si e kam rujt. Çorapja e vëllait, vetëm kjo mbeti prej tij. Pengu e dhemba për të", tha në një bisedë për këtë ekspozitë Mine Mulosmani.

Ajo ka dorëzuar kampionin e ADN-së në ICMF, për të kërkuar estrat e tij.

Të mbijetuarit thonë se fëmijët e pleqët që vdisin varroseshin jashtë kampit, por vendet e varimit kanë ndëmuar tri herë. Rripat e tokës kur preheshin të vegjlit ishin në kohë të ndryshme, të ura e Blëngës, buzë lumit, e nëpër shpate të pjerrtita. Gjatë dimrit, lumi që vërshonte i merre, duke u marrë prindërve kujtmet e vetme që kishin me foshnjat që nuk u rritën kurrë. Skicat e Lekë Pervizit i dëshmojnë edhe varret e parumëta.



Emri mbi Metal



Mark Shllaku

"Kam me vete një teneqe. Kur t'më çojnë me m'pushkatu buzë Kirit, do ta lidhi për kambë e aty do të shkruaj emnin tem, kshu qi do ta kesh ma të lehtë me m'gjetë"


- Mark Shllaku.

Mësuesi i malësive të Pukës e Shkodrës, i dashuruar me pikturën dhe poezinë, aktor e sufler në Teatrin "Migjeni", Mark Shllaku "takohet" me të bijën, Julin, vetëm në copa letrash. Dikur, ai i ka mësuar përmendsh "Lahutën e Malcis". Sot, ajo i prek letrat e holla të duhanit "Ylli i kuq", duke dashur të takojë përmes tyre mollëzat e gishtave të babës, si atëherë, kur ajo ishte krejt e vogël e ai, krejt i gjallë. Kanë kaluar 70 vjet, ajo është krejt e madhe, e ai, krejt i humbur. Fjalët janë po ato, amaneti po ai. I paqarur në vend. "Baba ishte i butë shumë. Na i plotësonitë të tana dëshirat. Na pat ba edhe kafaz me lepuj, që të luejshim me ta. Na merrte në shkolla verore dhe ne mezi pritshim me ardhë ai në shtëpi," thotë Juli me sytë e ujtë.

Një ditë të shtatorit të 1948-s, Mark Shllaku u nis për në shkollë. Mëngjesin e asaj dite nuk e dinte se nuk do të kthehej më kurrë në shtëpi, as i gjallë, as i vdekur. E arrestuan si organizator i celulës së Partisë Socialdemokrate në Shkodër. I vëllai ishte arratisur dhe i ati i Markut ishte internuar në Tepelenë. Pas 11 muajsh hetuesi, më 25 gusht 1949, Gjykata Ushtarake në Shkodër vendosi ta dënonte me vdekje, me pushkatim. E bija ishte atëherë vetëm 8 vjeçe. Sapo kishte mësuar të shkruante e të lexonte kur iu drejtua kryetarit të Degës së Brendshme në Shkodër. "Ai ishte në një nga kto shpëtë e bukura të konfiskuara. Më çoi mama der' te dera e më tha si me sjellë. Hyna në një sallon të madh. Iu prezantova dhe iu luta për një takim me babën. Ai më dha një copë letër të firmosme", kujton Juli. Atë ditë e pa babën përmes hekurave. "Kena shku me mamën dhe jena taku. Baba tha që kam shkru disa letra e i kam futë në dyshek, që ta merrshim. Tha se kishte ba një copë metalike, teneqe. 'Kur t'më çojnë me m'pushkatu buzë Kirit, do ta lidhi për kambë. Kam shkru emnin tem në të, kshu qi do ta kesh ma të lehtë me m'gjetë. Mue më tha: Mos u merrzini dhe mësoni! Te shkolla e kishte hallin," kujton Juli. Mark Shllaku e kishte ditur mirë se trupat e të pushkatuarve ishin zhdukur.

Mes ditarëve të shkollës, mësuesi ka lënë letra me poezi. Është e vetmja fletore që i ka shpëtuar kontrolleve të Sigurimit,

pas arrestimit. "Kanë mendu që është fletore e imja", thotë Juli për shënimet e babës. I hap me radhë dhe lexon poezitë, viti 1946, viti 1947. Mes tyre shquhet poezia "Çinarët", kushtuar vendit ku pushkatoreshin të dënuarit e komunizmit, pas varrezave të Firmajit. Vargjet e poezisë së tij pothuaj e përshkruajnë atë që ndodhte netëve pranë dy çinarëve, çka sot na tregon se Marku e dinte se qyteti ishte nën pushtetin e frikës, e se ai mund të ishte edhe fati i tij.



Kur pas ekzekutimit e shoqja, Angjia, mundi të merrte sendet personale nga hetuesi, në dyshek gjeti një letër të mbrame. Letra i drejtohet Angjes, gruas që dëshoi vajzës me të cilën qe njohur në moshë të re, dashuruar e martuar shpejt, sikur ta dinte se nuk kishte shumë kohë. Ai ishte vetëm 22 vjeç kur u bë baba.

Në letrat e duhanit të kohës, Marku që pret të vdesë kujtohet të shënojë borxhet për shtëpinë që patën ndërtuar bashkë dhe lë amanetet. Pothuaj me lutje kërkon të ketë një varr. Nga dëshmitë e lëna me shkrim, i dënuari ndihet të jetë krejt i vrarë, ende pa e qëlluar.

"E dashtuna Angje!

Jam lidh kamsh e duersh. Edhe pak orë me kanë mbet me jetue. Mendjen e kam te ti e fëmija që nuk muja me ju gëzue. Tashmi më kanë pikëllue shumë fytyrat tuaja që më dalin parasyshe e s'më lanë me deké... banu e fortë..."

Pas ekzekutimit, Angjia, ndihmësmjeko në zë në Shkodër, paguan një burrë që të kërkojë trupin e të shoqit. E kërkojnë në Kir pranë çinarëve, por nuk e gjejnë. Regjimi nuk jepte të dhëna e, prej 70 vitesh, familja e tij kërkon të çojë në vend amanetin e Markut, por ende nuk e di ku prehet trupi i tij. Pas 1990-s, Juli me të shoqin kanë pyetur ish-hetues të kohës. Dëshmi të pakonfirmuara përmendin malin e Frençit, në një natë me shi dhe një varr të cekët...

7 Varret e një familjeje



"Mbramë, në ora dy mbas mesit të natës u zbulue në seksion se ku ndodhet Jup Kazazi. Në rrethimin që i bërnë shtëpisë dhe mbasi si e pa se neve e gjetëm bodrumin ku ishte mëshetur dhe s'kishte shpëtim, vrau vehten. Këtu popullarizohet se e vramë neve (në dokument nënvizohet me shkrim dorë "Mirë", që nënkupton se e miratojnë). Kemi gjetur disa dokumenta, por ma të randësishmet do t'ua dërgojmë. Zoi Themel".

Dokumenti i mësipërm tregon qëndrimin zyrtar që mbajti regjimi komunist për vdekjen e Jup Kazazit, ndër organizatorët e kryengritjes së Postrbës, e para antikomuniste në Europën e Lindjes, që po niste instalimin e perdes së hekurit.

Më 9 shtator 1946, duke synuar që me "Postrbën" të lironin të burgosurit e të merrnin institucionet, shpërtheu para kohe ajo që sot njihet si Kryengritja e Postrbës, me disa qindra kundërshtarë të regjimit, mes të cilëve, vëllezërit Kazazi. Duke qenë më të paktë në numër dhe me armë, kryengritësit dështuan, ndërsa pushteti u bë më i egër duke arrestuar mbi 1200 veta, hapur 11 burgje të përkohshme e vranë dhjetëra të tjerë. Jupi shpëtoi, por u detyrua të fshihej dhe u strehua te daja i tij.

Me 17 shtator, shtëpia ku fshihej u zbulua, pasi u torturua një dëshmitar që kishte dëjoni. Duke mos dashur të binte i gjallë në duart e komunistëve, ai thirri "Rrnoftë Shqipëria. Nuk i dorzohem klyshëve t' Stalinit" dhe vrau veten. Ekzekutorët futën në shtëpi të kontrollonin të vdekurin, nipin 16-vjeçar, Ahmet Kopliku.

I biri i Jupit, Hamza Kazazi thotë se të atin e masakruan edhe për së vdekuri, kënduan e hodhën vallet dhe e ekspozuan në qytet.

Pas ngjarjes, 7 anëtarë dhe të afërm të familjes Kazazi u ekzekutuan, vranë veten ose vdiqën, ndërsa dhjetëra të tjerë u internuan. Trupat e të vrarëve nuk u kthyen kurrë familjeve. 73 vite më pas, ende nuk ndihen varret e:

- 1- **Halit Kazazi** (vëllai i madh): lindur më 3 mars 1900, i dënuar më 1945 dhe ekzekutuar më 1945 në Shkodër.
- 2- **Jup Kazazi** (vëllai i dytë): lindur më 6 tetor 1905, vret veten e nuk dorëzohet, më 17 shtator 1946.
- 3- **Salt(Seit) Kazazi** (vëllai i tretë), lindur më 9 prill 1913. Rrethohet në shtëpinë e Hafiz Adem Kazazit. Nuk dorëzohet e vret veten më 6 tetor 1946.
- 4- **Abdullah Kazazi** (xhaxha i Jupit), arrestohet për kryengritjen e Postrbës, pushkatohet diku në Shkodër pas 1946-s, në

moshën 64- vjeçare.

5- **Rifat Kopliku**, daja i Jup Kazazit. Pas arrestimit më 17 shtator 1946 sepse strehoi nipin, u ekzekutua më 24 shkurt 1947.

6- **Oaman Kazazi**, kushëri i parë i Jup Kazazit, arrestohet më 17 shtator 1946, dënohet me pushkatim dhe thuhet se vdiq në hetuesi, në moshën 24-vjeçare.

7- **Asim Abdurrahmani (Shpuza)**, djali i tezes së gruas së Jup Kazazit. Inxhinier, kimist, dënohet me pushkatim si spiun. Arrestuar e pushkatuar në Tiranë, më 8 qershor 1947.



I biri i Jupit, Hamza Kazazi, pas 1990-s ka nisur kërkimet për eshtrat e të afërmeve. Ka gërmuar në Kir, sipas dëshmiave të një 13-vjeçari që kishte shkuar të lahej më lumë, kur ka parë të varrosët një burrë me pizhame (si në fotot e trupit të pajetë të Jupit), në vendin ku më vonë u vu Drojtorja e Ujërave, pas varrezave të Rrmajit. Hamza Kazazi, pas shumë gërmimesh, nuk arriti dot të identifikonte të atin, por gjeti eshtra të mbështjella në një veladon, me dorë në zemër e me një kryq, që mendohet se qenë eshtrat e një prifti dhe ia dorëzoi peshkëvit, imzot Zef Simonit në Shkodër. Ndërsa kërkon 7 të zhdukurit e të prej 30 vitesh, ka arritur të kuptojë se "proceverbaleat baheshin të rrejshme". Në qershor 2017, Jup Kazazi, qyteti i Shkodrës i ka dhënë titullin "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) dhe Presidenti i Republikës, Nishani, i ka akorduar "Dekoratën e Artë të Shqiponjës" (pas vdekjes).

Legjenda e qershisë

Giuseppe Terrusi

Ishte njëherë e një kohë, një pemë qershie që lulëzonte çdo pranverë në rrethinën pranë Burgut të Burrelit. Ata që e shihnin, thoshin se lulet e saj bien mbi tokën ku prehen eshtra të dënuarish pa faj. Sa herë çelnin lulet, të burgosurit e shpëtuar gjallë luteshin për të vdekurit dhe admironin qershinë që lulëzonte vetëm për ta. Është pothuaj legjendë ajo pemë, që sot nuk është më. Të burgosur politikë që e kanë kaluar një pjesë të jetës në atë burg thoshin se nën rrënjët e saj prehej edhe një bankier italian, Giuseppe Terrusi.

Ai kishte ardhur në Shqipëri në prill 1926, kishte punuar në bankën e Gjirokastrës, më pas drejtor i bankës së Vlorës. Dëshmitë e tregojnë tërësisht të papolitizuar.

Më 1945 arrestohet nga regjimi komunist që po instalohej. E akuzojnë se ua ka dorëzuar me dëshirë bankën gjermanëve, ndonëse dëshmitë tregojnë të kundërtën. Është baba i një djali, është martuar me një italiane që e ka njohur në Shqipëri dhe është kunati i një sportisti në zë që ka përfaqësuar Shqipërinë. Aurelia Poselli, duke shfrytëzuar njohjen e kahershme, shkon në Komitetin Qendror të takojë Enver Hoxhën për t'i kërkuar t'i falë të shoqin, por ai nuk e pret. Janë vitet 1948-1949. Giuseppe Terrusi, nga Vloja është dërguar në burgun e Burrelit. Familja e tij, djali dhe gruaja riatdheshohen në Itali, ndërsa ai mbetet i vetëm në burgjet shqiptare. Giuseppe vdes në burgun e Burrelit më 2 mars 1952. Thuhet se u varros pranë pemës së qershisë ku varroseshin të burgosurit deri më 1955.

Që nga viti 1993, i biri, Aldo Renato Terrusi, që kujton të atin si një burrë që e ka parë vetëm një herë në burg, ka ardhur më shumë



se 10 herë në Shqipëri. Ka vetëm një peng, të gjejë eshtrat e të atit që t'i çojë të prehen pranë eshtrave të së ëmës, siç qe amaneti i saj. Ende nuk ka mundur t'i gjejë, për shkak të lejes së munguar për të gërmuar në Burrel. Kujton se në 2012-n ka vajtur në burgun e Burrelit dhe punonjës të administratës shqiptare debatuan para tij për çështje teknike, por nuk e lanë të merrte lopatën në dorë.

"Qershia është bërë objekt legjendë, sepse njerëzit varroseshin aty rrotull. Legjenda thotë se kjo qershi rritej nga gjaku i burgosurve të varrosur". (citim per panelin)

Thika e Artë

Venanzio Lozzi

"Ishte një thikë e florinjte, e ngulur në barkun e kufomës, veçse jo në drejtimin e zakonshëm, por në të kundërt. Maja vezulluese e thikës kishte depërtuar nga brenda barkut, jashtë tij..." vite më parë gazetari Ferdinand Dervishi pat mësuar se kjo frazë që gjendet në një nga veprat e Ismail Kadaresë, nuk qe e rastësishme. Duket që ai të ketë marrë shkas nga një ngjarje e ndodhur në Shqipëri në 1946-s.

Kur lufta mbaroi dhe Europa nisi ndarjen në Lindje e në Perëndim, Tirana që çirohej nga një tirani, por binte në krahët e tjetrit. Italianët e mbetur në Shqipëri nga lufta, pothuaj po mbaheshin peng, me pretendimin se, "duhej të mbaronin punimet e nisura", apo se, "... duhej të kontribuonin në rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta", apo thjesht se, "... nuk kemi mjaftueshëm specialistë". Mes tyre, ishte edhe një mjek në zë, Venanzio Lozzi, ose Doktor Losi, siç mbahej mend nëpër Tiranë deri vonë. Ai kishte mbërritur në Shqipëri për të ushtruar profesionin e kirurgut, rreth majit të vitit 1939.

Profesor Venanzio Lozzi, i biri i Andreas dhe Antonina Teças, lindur më 1 dhjetor 1900 në Fagnano Alto të Aquilla-s në Itali, banonte në Tiranë, ishte kirurg i Spitalit të Përgjithshëm Civil dhe konsulent i Spitalit të Përgjithshëm Ushtrarak, me arsim të lartë, i martuar me tre fëmijë.

Përfaqësia diplomatike italiane u përzua më 14 janar 1946. Nisën arrestime e pushkatime italianësh në Tiranë për sabotazh, ndaj shumë prej tyre ikën fshehurazi.

Kolegu italian Franco Benanti, kujtonte më vonë se Prof. Lozzi kishte fituar emër të mirë mes banorëve të kryeqytetit, po u akuzua për kontrabandë floriri. "E kishin parë të vizitonte legatën amerikane dhe ipeshkvinë e Durrësit. E patën lënë të shkonte të vizitonte familjen në Itali, me kusht që të mos rrinte gjatë atje. Sipas prokurorit, ai kishte

futur në barkun e italianëve të operuar sende të çmueshme, si flori, bizhuteri, etj."

Kur doktor Lozzi arrestohet me tetë anëtarë të stafit të spitalit, e akuzojnë se ka "marrë pjesë aktive në organizimin e arratisjes së grupit të parë të italianëve, përbërë nga Canavese, Collessanti, Morgante dhe Saraceni; për planin pranon të bëjë në shtëpinë e tij mbledhje ilegale dhe vihet në dispozicion me gjithë makinën e tij...; ka ndihmuar disa italianë të largohen nga Shqipëria; po përgatitej edhe vetë me të tjerë për t'u larguar".

Mes akuzave nënvizohet se doktor Losi ka pasur dijeni për transportin e paligjshëm për në Itali të rreth 1000 napolonave flori që ishin në pronësi të një italian. Shtohet se një sasi të madhe flori e ka nisur drejt Italisë duke e fshehur në arkivolin e komandantit partizan të batalionit "Antonio Gramshi", i rënë në Shqipëri. Të dhënat e vendimit të Gjykatës Ushtrake të Tiranës përputhen me përshkrimin e Kadaresë, mbi një thikë të florinjte në trupin e një kufome.

Atëkohë, shteti kishte nxjerrë një ligj për sekuestrimin e të gjithë floririt dhe ndalimin e nxjerrjes së tij jashtë vendit. Pavarësisht se i kujt ishte, tashmë qe pronë e shtetit.

Një vendim i Gjykatës Ushtrake të Tiranës i datës 3 gusht 1946, e dënon Venanzio Lozzin me pushkatim. 13 ditë më vonë, më 16 gusht i njëjti vendim jepet edhe nga Gjykata e Lartë. Mbi të, në të njëjtën ditë, gjendet edhe firma e Enver Hoxhës, me cilësinë e Ministrit të Mbrojtjes Kombëtare dhe Komandantit Suprem. Shkresa e Enver Hoxhës përfundon me fjalët: "Njoftoni datën e ekzekutimit dhe fjalët e tyre të fundit". "Jam në duart tuaja, mundësisht të më falni...", shkruhen në dokumentin përkatës fjalët e fundit të kirurgut të shquar, në formën "doktor Losi".

Sipas hulumtimeve të Kastriot Dervishit, ai është ekzekutuar pranë urës së Bregut të Lumit. I biri që jeton në Australi ka tërhequr dosjen e të atit në vitin 2011 dhe është interesuar për varrin e doktor Losit përmes Ambasadës Shqiptare në Kinë. Ende nuk i dihet varri.

Kryqje pa Varre



I Lumi Dom Shtjefën Kurti është vetëm një prej klerikëve të krishterë që janë ekzekutuar në komunizëm dhe ende pa varr. I ardhur nga Kosova më 1930, në shtator 1943, ai lajmëronte Arqipeshkvinë se po pagëzonte hebrej, me gjasë për t'i shpëtuar nga nazistët, sepse me pagëzimin merrnin emra të rinj e pasaporta shqiptare. U arrestua për herë të parë më 28 tetor 1946 për agitacion e propagandë dhe u dënua me 20 vjet burg. Ai kishte refuzuar të shkëputej nga Vatikani dhe e çuan në Burrel, por nuk u dorëzua as mes torturave. E çuan të hapte varrin e tij, por nuk e pranoi akuzën. E kthyer në qeli, ku natën e Krishtlindjeve dëgjohej të thoshte mesheën, i përlotur. Dikur e liruan nga burgu. Kishte ishin mbyllur dhe e dërguan në Gurrëz (Milot), ku e lanë të punonte magazinier në kooperativë. U arrestua përsëri më 11 qershor 1970. Gjyqi për të zhvillohej në Kishën e Zojës së Këshillit të Mirë në Gurrëz, godinë e kthyer në vatër kulture pas prishjes së vendimit të diktatorit për të ndaluar besimin fetar. U dënua me vdekje "in odium fidei", pse pagëzoi ilegalisht një fëmijë. Një ditë të trishtë vjeshtë, 20 tetorin e vitit 1971, ai u mor nga qelia dhe u vu para togës së pushkatimit. Kur e pyetën nëse i vinte keq për jetën, tha: "Më vjen keq që po ma merrni ju". Akuzat zyrtare kishte qenë sabotim. Por koha do të hihte dritë.

Në vitin 2011, nipi i tij, Nikolin Kurti, ka mundur të takojë prokurorin që kërkoi dënimin, Hajredin Fuga, dhe gjykatësin që mori vendimin, Jani Vasili. Të dy i kanë lënë një ndjesë të shkruar me dorë, për çfarë ka ndodhur me meshtarin. Nikolin Kurti i ka botuar letrat në janar 2019, duke respektuar dëshirën e Fugës e Vasilit që letrat të publikoheshin pas vdekjes së tyre. Hajredin Fuga dhe Jani Vasili kanë ndërruar jetë pak vite më parë. Pas rënies së sistemit komunist, ata vazhduan karrierën e tyre në sistemin e drejtësisë, duke arritur deri në Gjykatën Kushtetuese.

Në letrën e tij të ndjesës, prokurori Fuga ka thënë se çështja për Dom Shtjefnin pati nisur me pak dritë të vjedhur në kooperativë, derisa në të përfshinë edhe emrin e priftit. Në letrat ai vëren se atë kohë, çështja iu hoq Krutës dhe e mori Ministria e Brendshme, por shtonte se sipas vartësit të tij që kishte qenë i pranishëm, ekzekutimi ishte bërë natën. Vete Fuga nuk kishte dijeni për të dhëna që mund të ndihmonin në gjëjetjen e eshtrave.

Studiuesi Kastriot Dervishi ka publikuar së fundmi proesverbalin mbi "ekzekutimin e Shtjefën Jak Kurtit", ku thuhet se "mbas fjalës së fundit u krye ekzekutimi dhe mbasi u konstatua nga mjeku Asim Ylli se kishte vdekur, u veprua sipas autorizimit përkatës, duke iu dhënë rezultati Dr. Asim Yllit nënshkruar nga Kote, Sulit, Lalimi dhe Ylli". Termi "rezultat" që i jepet doktor Asim Yllit, nënkupton që trupi i pajetë i është dhënë njërit prej mjekëve që rezultoi

edhe në raste të tjera që ka tërhequr trupa të pajetë të dënuarish për nevoja të Fakultetit të Mjekësisë, në mësimin e lëndës së anatomisë. Dervishi thotë se "për ndonjë rast, kam dyshime se mund të jetë varrosur në parcelën e spitalit të burgut në Tulinë, aty ku janë varrosur ata që vdisin gjatë vuajtjes së dënimit në Tiranë".

Mes 38 martirëve të njohur nga Vatikani, 20 u pushkatuan dhe trupat e tyre mbetën pa varr. Gjykata Kishtare për Çështjen e Martirëve në Shkodër, e ngritur për shqyrtimin e dosjes së 38 martirëve që u lurtuan nga Vatikani pas 9 vitesh hulumtim, dëshmon se gjatë regjimit komunist në Shqipëri u pushkatuan 31 klerikë, vdiqën në tortura 8 të tjerë, u mbytën pa gjyq 3, vdiqën në burgje e kampe internimi ose pak kohë mbas torturash 23, dolën nga burgu pothuajse të vdekur 66 klerikë të tjerë. Ndër 135 klerikë që ishin në të gjithë Shqipërinë, u martirizuan 131. Për këto të dhëna janë shfrytëzuar të gjitha arkivat, qoftë ato të Shtetit e të Sigurimit në diktaturë, ndërsa problemi më i madh ka qenë të mungesa e të dhënave e dokumentacionit për shumë persona të cilët janë ekzekutuar pa gjyq. Janë gjendur certifikatat, por në amzë nuk është shënuar data e vdekjes në ditën kur janë ekzekutuar.



Dy Ditë

REVOLTA E SPAÇIT

Liri


"Partia më tepër kujdesej për stallat e lopëve, sesa për njerëzit". Kjo fjali e thënë shkujdesur nga Pal Gjergj Zefi nga Frushkulli i Durrësit në të tridhjetat e tij, e çon atë në burgun e Spaçit, për agjitacion e propagandë. Është viti 1973, koha e "liberalizmit" ka përfunduar. Pal Zefi mbërrin në burgun mes maleve, në një hon ku nuk ndihen më gjurmët e njerëzimit. E nis dënimin 10-vjeçar duke refuzuar të punojë në minierë. Ai kërkon ta kryejë dënimin me burg, jo me punë të detyruar.

Refuzimit të tij komanda i përgjigjet me izolim. Kur kryen izolimin e parë, e refuzon sërish punën dhe lihet prapë në birucën e lagësht. Të dënuarve me izolim që vireshin në biruca të errëta e të ngushta, u jepej natën vetëm një batanije.

Në orën 5.00 të mëngjesit të 21 majit 1973, gardiani hyn në dhomën e Pal Zefit për të marrë batanijen. Zefi që ka kohë në errësirë, del me vrap nga dhoma e izolimit, i zë dora një shufër metali dhe ngjitet në tarracë. Gardiani i bën thirrje të kthehet në dhomën e dënimin, ndërsa Zefi i kërkon t'i rrijë larg, sepse do të godiste këdo që i afrohej.

Ndërsa në ndihmë të gardianit të parë vijnë të tjerë, në ndihmë të Zefit tashmë janë të burgosurit e tjerë. Nis përplasja mes të dënuarve politikë dhe gardianëve të repartit 303.

Kështu nisi e u përshkallëzua ajo që njihet si Revolta e Spaçit dhe zgjati dy ditë. Të dënuarit refuzonin të dorëzonin Pal Zefin, duke i bërë rojat të tërhiqeshin nga zona e të burgosurve. Ata mbledhën përfaqësitë e tyre, kërkuan të rishihen vendimet e dënimeve të tyre, të bëhen falje, të përmirësohen kushtet e punës dhe arritën deri te parullat politike, si: "Poshtë komunizmi" dhe "Rrotë Shqipëria e Lirë!", "Ju do të vini këtu dhe ne do të zëmë vendin tuaj", "Ushtria është me ne", "Populli është me ne". U ngrit mes tyre një grup që do të bisedonte me komandën, ndërsa ditët e revoltës shenjau ditët e lirisë në kamp: Gëzim Çela kujtohet të ketë kënduar me kitarë dhe për herë të parë u ngrit flamuri pa yllin e kuq. As me ardhjen e zv.ministrit të Brendshëm nga Tirana, Feçor Shehut, ata nuk u tërhoqën. Revolta u shtyp me dhunë mëngjesin e 23 majit 1973, pasi



forca ushtarë shkuan nga Tirana në Spaç, pranë Mirditës. U arrestuan shumë prej të dënuarve, 12 prej të cilëve u sollën në Tiranë ku u bë gjyqi në orën 23.00 të natës, mes tyre edhe Pal Zefi (32 vjeç), Skënder Daja (28 vjeç), Dervish Bejko (27 vjeç) dhe Hajri Pashaj (23 vjeç), që u dënuan me vdekje. Në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor më 24 maj, kryetari i Gjykatës së Lartë, Aranit Çela, tha: "Ne themi që të dënohen me vdekje (pushkatim) dhe të pushkatohen jo përpara të tjerëve dhe jo para kampit".

Asnjëri prej tyre në pyetjet e bëra në gjyq nuk i shiti shokët: ata nuk treguan se kush bëri thirrjet, as kush ngriti flamurin. Dëshmitë e tyre nisën me "unë nuk e di se kush e bëri, se nuk e pashë". Dëshmitari Xhemal Balli, ish-i burgosur, ka thënë se të katërt "i pushkatuan në orët e vona të mesnatës, në malet e thepisura dhe pyjet e Mirditës".

Të katërt u ekzekutuan pasi iu kërkuar të shkruanin letrat e fundit, ndërsa 64 të burgosur, të cilësuar si më aktivët në revoltë, u ridënuan me shumë vite.

Ditët e revoltës, Pal Zefi kishte thënë se nuk kthehej më i gjallë në birucë. E detyruan ta mbante fjalën. Lugina e tmerrit e mori me vete dhe trupi i tij, bashkë me ato të miqve të pushkatuar, nuk u gjet kurrë...

SPAC

"Sh.gjyqtari! të akuzuarit nuk i kam akuzuarë se kanë jetuarë në vilën Azona e La Rossa...I kam akuzuarë se të gjithë atje e kuptuan se kishin të bënin me Shërbimin Sekret të Ballkanit me agjentë Fultz-in...bashkëpunuanë me ta e pranuan të bëhen agjentë të tyre"- shkëputur nga pretenca e prokurorit për Xhemal Farkën e 25 të tjerë

Gazetari i "VILA A la ROSSA"

Ka qenë në Bari një vilë "Azona e La Rossa" ku shumë shqiptarë takoheshin me njëri-tjetrin. Në takimet e tyre, shpesh kishte edhe të huaj të lidhur me Shqipërinë. 25 prej atyre shqiptarëve, pas kthimit në atdhe u përballën me akuzën si agjentë të huaj, tradhtarë të atdheut dhe agjentë që donin të rrezonin pushtetin popullor. Nga shteti i kohës njihen me emrin "grupi i spiunëve të Vilës S.B.S- Bari". Një prej tyre, ishte një rriosh i qeshur nga Tirana.

Në gazetën "Arbëria" të viteve 1930 gjendet me pseudonimin Sula i Fajës, Xh.F. Xhefar, ndërsa për miqtë ishte gazetari satirik socialdemokrat Xhemal Farka.

Lindur më 1913 në Tiranë në një familje qytetare. Pas Institutit të Harry Fultz në Tiranë, kishte mbaruar Universitetin Amerikan të Bejrutit, me bursë të dhënë nga Solir Kolea për të studiuar koloninë shqiptare të atjeshme, kishte qenë gazetar në Radio Bari dhe kishte punuar për Zërin e Amerikës në Jeruzalem.

Xhemal Farka shkruante për problemet sociale që kalonte shoqëria shqiptare, si "Fëmijët e natës", që lypnin rrugëve; në dialekt tiranas me pseudonim, mbështeste emancipimin e femrës shqiptare dhe kryente hulumtime folklorike në trevën e Tiranës. Pas studimeve që rikthyer në atdhe, me idealizmin për të ndërtuar vendin, por ai u përballi dy herë me regjimin, të parën se ndihmoi Lef Nositin e të dytën si agjent e tradhtar.

Në AIDSSH, mes shumë dokumentesh të zbehta e gati të palexueshme ka dy procesverbale për të. Nga ai i datës 15 shtator 1945 del se e ka takuar për herë të parë Lef Nositin më 1938, në një festë në Elbasan ku gjendej dhe zri. Haslluk. Në këtë rast, Xhemal Farka kishte shkruar në festë si përkythyes i profesorit amerikan Filip Mosli, që ishte i ftuar. Siç duket, i pyetur se kush e sollti nga Elbasani në Tiranë Lef Nositin (kur i fshihje qeverisë komuniste), Farka përgjigjet që nuk e di. "Para tre a katër ditësh se të arrestohesha, jam pjekur përtej Pallatit të Zogut në një të panjohur, i cili më foli në emër e më tha se jam miiku i Vasil Nosit dhe dua të shkoj në Tiranë. Qe veshur me malokshme si ustallarët e Golloborodës. Bashkë me të kemi ardhur deri tek ura karshi fermës së Neki Radoviksës dhe të dy muarmë rrugë të ndryshme". Në letër shënohet të ketë thënë se pat dëshimë që qe Lef Nosi, por nuk mori guxim të pyste, që ta denonconte. Duke qenë se në procesverbalin nuk jepen pyetje që i janë bërë gazetarit nga hetuesit, mbeten të dyshimta edhe frazat që në fund është shtrenguar të firmosë.



Në një procesverbal të datës 17 shtator 1945, ai tregon se ka pasur mik prej kohës së Bejrutit, Vasil Nositin, dhe se prej tij dinte që Lefi ishte në kërkim. Në tri faqe procesverbal ai nuk pranon ta ketë strehuar Lef Nositin, por pranon se i është kërkuar ta kalojë Lef Nositin nga "mullini, deri te postbloku. Te ferma e mora Lefin për ta përcjellë dhe ta fusnja brenda postbllokut në Tiranë... Arritëm ndërmjet Legatës Amerikane dhe fermës, ku u paraqitën Vasilin me Markun në një karrocë. Nuk e di ku shkuan..."

Duke qenë në djathtë të faktit që dëshmitë merreshin nën tortura, nuk është e vështirë të kuptohet pse dëshmia e Farkës ka ndryshuar dy ditë më vonë.

Musine Kokalari, në ditarin e saj shënon se "një nga të burgosurit që e pashë përmes dritares sime të vogël në oborrin e burgut, më tha se ata po merreshin në pyetje Xhemal Farkën për mua. E kuptova. Ai nuk tha asgjë për mua dhe unë nuk thashë asgjë për të".

Fate të trishta



Ulliri i doktorit Lorenc Rasha

Lorenc Rasha, ish-student i Innsbruket në Austri, Profesor Doktor në linguistikë, njohës i 7 gjuhëve, ish-drejtor në gjimnaze dhe nacionalist, merr pjesë në Konferencën e Pezës, duke shenjuar me njollë të ardhmen e tij. Më 1944 arrestohet në Tiranë, cilësohet tradhtar i ideve të tij dhe e dërgohet në Paraspur, një fshat i thellë, rrezë Dajtit. Aty vihet para togës së pushkatimit. Fshatarët e zonës e njohin i kërkojnë komandantit të togës së pushkatimit ta falë, se ai i ka ndihmuar, por komandanti nuk pyet.

Lorenc Rasha ndërron jetë diku rrezë Dajtit, mes njerëzve që dikur pat ndihmuar. Ata që e qëlluan i morën këpuçët dhe robat, e lanë vetëm me të brendshme, pa e varrosur. Kur nata kishte rënë, njëri prej fshatarëve që e kishte njohur, e mori fshehurazi trupin e pajetë dhe e varrosi në oborrin e tij, pranë rrënjëve të një peme ulliri.

Askush nuk e di pse u pushkatua Lorenc Rasha. Në shtëpinë e tij e priten me muaj të tërë të kthehej i gjallë, sepse nuk ishin lajmëruar për ekzekutimin.

Dy litarë për inxhinierin Beqiri

Një vlonjat 32-vjeçar, ish-nxënë i Harry Fultz-it, që ka kryer me medalje të artë Inxhinierinë Civile në Vjenë, ka përfunduar piketimin e tharjes së Kënetës së Maliqit dhe pret të nisë zbatimin e punës. Është i martuar dhe është bërë baba kur, 6 nëntorin e vitit 1946, i vihen prangat në duar. Në korrik, katër muaj më parë ishte emëruar drejtor i punimeve.

Dy ditë më vonë, ai dhe miqtë e tij, të huaj e shqiptarë të ardhur nga jashtë, nxirren në gjyqin e improvizuar politik. Shqyrtimi i dokumenteve nga studiuesit ka treguar se dosjet hetimore-gjyqësore të këtyre proceseve janë tërësisht të manipuluar nga regjimi, sepse janë marrë e zhvilluar në kushtet më të rënda të torturës psikike dhe fizike.

Vendimi i gjyqit shpallet më 19 nëntor, 13 ditë pas arrestimit dhe më datë 21, me dënimin "sabotatorë të Maliqit", ai dhe kolegët transferohen nga qelitë e Tiranës për në Korçë, për të qenë sa më afër Kënetës së Maliqit. Rrugës, Beqiri ia dha paratë që kishte oficerit shoqëruar, që t'i blinte një paketë cigare. Nuk iu kthye kurrë kusuri, si për t'i thënë që në botën tjetër nuk do t'i duheshin.

Vendimi i gjyqit ishte të mos u falej jeta. Për Kujtim Beqirin e Abdyl Sharrën u vendos varja në litar. Më datë 22 nëntor 1946 u vendos të kryhej ekzekutimi në Maliq. Beqiri u vunë në litar, i hoqën stolin dhe po prisnin të jopje shpirt, kur e panë të ishte ende gjallë. Iu afruan dhe panë se litari kishte kapur jakën e palltos së inxhinierit, por jetën që ia falë ekzekutuesit. Fjalët e tij të fundit ishin: "Historia do ta tregojë se unë po dënohem e ekzekutohem pa faj". Kënetë e Maliqit u tha sipas piketimit të bërë nga Kujtim Beqiri, sepse as inxhinierët rusë që u morën për piketime të reja që do ta fajësonin të ndjerin, nuk i lëvizën vendimet e tij. Tharja nuk mund të bëhej ndryshe.

Atë natë jeta e tij u fik, por trupi i tij ende nuk ka gjetur paqe. I biri, Kadri Beqiri, prej 73 vitesh do të dijë ku janë eshtrat e babait. «I kemi kërkuar shumë eshtrat e babait në Maliq por, mjerisht, atje nuk kishte eshtra. Gjatë gërmimeve gjetëm vetëm një dorë njeriu, të cilën e futëm në arkivolin e vogël, sa për të pasur një varr të tij».

Vite më vonë, e bija është futur në Cirkun e Tiranës dhe shkon për shfaqje në qytete e fshatra. Më 1956, ajo është në Dajit për shfaqje. Quhet Vitore Rasha. Në fund të numrit, Vitores i afrohet një burrë me veshje kombëtare.

"Duke më parë në sy, gati në të lotuar, më thotë me zë të dredhur: Ju jeni goça e doktorit, të keqen baba? Po, i thashë unë. Do të thotë baba një gjë, por kurrë nuk do t'ia thuash njeriu. Pra, të mbetet sekret mes ne të dyve. Babanë tënd e ka varrosur baba këtu, në rrënjët e ullirit, brenda shtëpisë së vet. Unë banoj në Paraspur, një fshat në rrezë të Dajtit, në perëndim të tij. E kam unë, por ti mos fol, se sot është me zarr. Por do vijë një ditë që çdo gjë do shkojë në vendin e vet dhe ti duhet ta dish, që ta marrësh".

50 vjet më vonë, Vitore Rasha Sallaku, tashmë akrobate e njohur shkoi në Paraspur. Burri që i kishte treguar sekretin kishte ndërruar jetë, dhe ishte i biri që i ndihmoi për të nxjerrë eshtrat, që tashmë kanë një varr dhe një emër.



Akile Tasi, xhaxhai i Lekë Tasit

Akilenë, pas Maliqit e çuan në Burrel, në atë repart shpirttrash në venitje që fikeshin në gjysmerrësirë. Vdiq aty nga ceroza mbas 17 vjetësh burgim, në janar të vitit 1961, duke lënë kujtimet më të mira të të burgosurit, gjithmonë i gatshëm për të ndihmuar këdo që donte të mësonte anglishten. Në kohën që u sëmur, babai i Lekës nuk ndodhej në Burrel, sepse e kishin sjellë në Tiranë për ta operuar. Sapo vëllai u nis drejt Tiranës, Akile u përkeqësua. Kur Koço Tasi u kthye në Burrel, e gjeti të vëllanë të varrosur. Familja i kishte çuar ilaçe, por nuk arriti ta shihte edhe një herë të gjallë. Nga drejtoria e burgut u shkoi një telegram, ku njoftoheshin se njeriu i tyre kishte vdekur. Lekë Tasi thotë se shkoi të shihte vendin ku e kishin vënë, por nuk ia treguan. "Kështu u shtua edhe një varr pa emër në një oborr të mënjeluar brenda telave. Kemi marrë vesh vetëm që ditët e fundit, shërbimin Akilesë ia bënë dy djem që vuanin dënime të gjata, Agim Llanaj dhe Tomorr Dosti", thërrën Lekë Tasi në kujtimet e tij.

Skënder Çela, daja i Mirush Kabashit

Aktori i njohur Mirush Kabashi, pas 18 vitesh kërkime, 8 vjet më parë pati nisur gërmimet në Qafë-Piloçë të Pogradecit, për gjetjen e eshtrave të dy të rinjve durrsakë, të pushkatuar pa gjyq në dhjetor të vitit 1946. Bëhet fjalë për Mark Tocin dhe dajën e tij, Skënder Çela, dy të rinj që cilësoheshin antiparti. Pas shumë takimesh dhe kërkimesh, me ndihmën e gazetarit Fatos Baxhaku, ai kishte të dhëna dhe dokumente që vërtetonin se dy të rinjtë qenë ekzekutuar buzë liqenit të Pogradecit, nga Sigurimi i kohës dhe më pas, trupat e tyre u lanë në kodrat e Qafë-Piloçës. Ndonëse gërmimet zgjatën në kohë, ai nuk mundi t'i gjente eshtrat e dajës.



Të pagjetur

Ushtari i pagjurmë Sami Sulejman Aruçi

Më 7 prill 1970, Sami Aruçi u komandua me shërbim provë në komandën e Repartit Ushtarak nr.2820 në Fier. Më 8 prill, në një vizitë të beftë të eprorëve, ai nuk u gjend në vendin e caktuar, ndaj u dha urdhri që ta çonin në bateri. Mungesa e tij në bateri u vu re 11 ditë pas ndërrimit të vendit të shërbimit, kur do të organizohej zbori. Ishte mungesa e tij në apel që bëri të kuptohej se ushtari ishte larguar në drejtim të paditur. Në dokumentet zyrtare të Ushtarisë thuhet vetëm se ushtari u zhduk dhe se nuk kanë asnjë të dhënë për fatin e tij. Ushtar Samiu nga Maminasi i Durrësit është ende i zhdukur prej asaj dite, ndërsa familja e tij nuk është "internuar" dhe nuk ka pasur asnjë penalizim, siç ndodhte me familjet e të arratisurve. Vëllezërit dhe i ati atëkohë, i patën nisur letra ministrit të Mbrojtjes dhe vetë Enver Hoxhës, pa marrë kurrë përgjigje se ku iku Samiu. 23-vjeçari ishte njohës i disa gjuhëve të huaja dhe para zhdukjes, e ka lënë armën e shërbimit në vendin e duhur. Ndërkaq, familja ka mundur të marrë një shkresë zyrtare në vitin 2016, në të cilën thuhet se "dokumenti i hetimit të ngjarjes është i klasifikuar dhe nuk mund të shërbehet". Zyrtarisht, familjes i është thënë që djali është larguar nga reparti pa leje dhe në drejtim të paditur.

Lule në ajri - Dajlan Zaimaj

Kur 12 dhjetorin e 1944-s në portën e Zaimëve u dëgjuan trokitje, askush nuk e dinte sekondat në vijim, do ta shndërronin jetën e tyre. Të zotit të shtëpisë, i kishte ardhur thirrje nga Dega e Brendshme e Skraparit që të paraqitej në Degë. Para se të nisej, së shoqes, e tre fëmijëve u tha "mos kini merak" dhe iku. I biri Gramozi ishte 9 vjeç dhe ishte fëmija i madh, pas vetes kishte tri motra. Ishte hera e fundit që e panë të atin, ai, nuk u kthye më kurrë.

Akuzohej si pjesë e forcave të Ballit Kombëtar. Një vit më vonë u dënua me 101 vite burg. Me faljet e dy viteve më pas, dënimi iu ul në 25 vjet burg. Shteti i kohës i sekuestroi pasurinë familjes që mezi mbijetonte. Nga burgu, Dajlan Zaimaj u çonte letra të afërme dhe u kërkonte të shkonin ta shihnin. "Ejani shihni të sëmurin", kaq kujton i biri nga letrat e të atit. Më 2 qershor 1949, pas 10 vitesh vetmie, vdiq në burg nga torturat, sëmundja dhe uria. I biri, Gramozi, thotë se e mban mend të anë si një mesoburrë, disi të mbushur, që mbante ngahera një kapelë me strehë. Nuk ka asnjë fotografi të tij. Trupi nuk iu dorëzua familjes dhe nuk dihet ku është as sot. "Më kanë thënë 'nuk ka gjë këtu, po si gjithë të tjerët shko e hidh lule atje matanë se i kanë zënë pallatet varrezat. Atje e kanë rrafshuar kanë bërë varreza, pallate, fushë sporti"- thotë Gramozi.

Ish-të dënuar në Burrel thonë se të vdekurit i varrosnin në të njëjtin vend, "përballë dritareve të qelive mes dy rrethimeve, në mënyrë që të gjithë ta shihnin se ç'fund do të pësonin. Kufomat, cullake - rrobat dhe gjërat e tjera i ndanin mesvedi xhelatët - të mbështjellë me batanije i varrosnin në radhë, njërin ndanë tjetrit, pa emër dhe pa asnjë nishan".

Rrugëtimi

2006

Hyn në fuqi Koventa

Më 20 Dhjetor 2006, në Nju Jork hyn në fuqi Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë, OKB.



2010

Krijohet Task Forcë

VKM për krijimin e Task Forcës për kërkimin dhe gjetjen e eshtrave të personave të zhdukur gjatë komunizmit.

2017

BE nis mbështetjen

Korrik 2017, BE Mbështet Projektin Pilot të ICMP në lidhje me varrezat masive të Dajtit dhe Ballshit, në bashkëpunim me IIPP dhe AIDSSH.



2019

31 tetor 2019

ICMP i dorëzon autoriteteve Shqiptare raportet e para identifikuese me ADN të viktimave të komunizmit.

11 nëntor 2019

Urdhër i Kryeministrit për ngritjen e grupit ndërinstucional të punës për identifikimin dhe kthimin në atdhe të eshtrave të shtetasit italian Giuseppe Terrusi.

Dhjetor 2019

Projekt i përbashkët ICMP-AIDSSH "Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimtë të zhdukurit në komunizëm".

Shqipëria firmos

8 nëntor 2007, Republika e Shqipërisë është nga vendet e para që e ratifikoi marrëveshjen.

2007



Plani i Ri

4 dhjetor 2015, Plani i Veprimit i Qeverisë për identifikimin dhe gjetjen e personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste në vendin tonë.

2015



4 qershor 2018

Raportim i Shqipërisë mbi zbatimin e Konventës së OKB-së në Komitetin e ekspertëve të Konventës.

10 korrik 2018

Samiti i Vendeve të Ballkanit, Londër, në kuadër të Procesit të Berlinit, Shqipëria firmos një deklaratë të përbashkët, "Mbi Personat e Humbur".

30 gusht 2018

AIDSSH dhe ICMP prezantojnë Qendrën e Kërkimeve Online dhe Gjurmuesin e Vendvarrimeve - Aplikacione Online

15 nëntor 2018

Parlamenti ratifikon Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Keshillit të Ministrave dhe ICMP

2018

